



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE - MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE - MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE  
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

Bazuar në nenin 9 të Ligjit 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i ATK-së nxjerrë:

## *Shpjegim Publik*

Ky Shpjegim publik është në përputhje me nenin 7 të Rregullores 2004/51 mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave dhe nenit 9.2 të Rregullores 2004/52 mbi Tatimin në të Ardhurat Personale. Qëllimi i këtij shpjegimi është për te sqaruar se si ATK do të interpretoje dhe zbatojë dispozitat e legjislacionit që administron me qëllim që të shpjegoj mënyrën për:

### *Trajtimin e ndërmarrjeve të privatizuara për qëllime të zhvlerësimit*

Me qëllim të përcaktimit të vlerës nga çmimi i blerjes, e cila do të përdoret si bazë për qëllime të zhvlerësimit të mjeteve themelore, nga blerësi duhet të respektohen hapat si në vijim:

#### *Hapi 1: Përcaktimi i vlerës së mjeteve themelore:*

Gjatë privatizimit janë blerë aksionet e ndërmarrjes NEW CO ( ndërmarrja e re e themeluar nga AKM ). Me anë të procesit të blerjes (privatizimit) nga NEW CO tek blerësi është transferuar:

1. Toka
2. Mjetet e kategorisë së parë ( Ndërtesa dhe struktura tjera ndërtimore)
3. Mjetet e kategorisë së dytë
4. Mjetet e kategorisë së tretë
5. Stoqet
6. Obligimet
7. Kërkesat

#### *Vërejtje:*

*Vlera e stoqeve do të gjendet përmes kostos historike apo përmes vlerës neto të realizueshme sipas Standardit Kosovar të Kontabilitetit nr. 2, cilado nga dy vlerat që do të jetë më e ulët. Kurse vlera e obligimeve dhe e kërkesave është e njohur.*

*Gjatë procesit të llogaritjes së vlerës së asetëve për të cilat do të përlllogaritet zhvlerësimi, obligimet dhe kërkesat do të përcaktohen bazuar në kontratat të cilat nënshkruhen në mes të AKM-së dhe Blerësit.*

Për të nxjerrë Vlerën e cila do të përdoret si bazë për të bërë zhvlerësimin e mjeteve themelore, duhet të përdoret formula:

**Vlera e mjeteve themelore = Vlera e paguar për Aksione + Obligimet – Kërkesat – Stoqet**

Më pas kjo vlerë e gjendur përmes kësaj formule do të jetë bazë për të bërë shpërndarjen për secilën kategori të mjeteve themelore varësisht nga përqindja e pjesëmarrjes së mjeteve themelore në vlerën totale.

**Hapi 2: Llogaritja e përqindjes së pjesëmarrjes së mjeteve themelore në vlerën totale të definuar nga Tatimpaguesi**

Grupet nëpër të cilat do të bëhet shpërndarja e vlerës së Mjeteve Themelore janë:

- **Grupi 1:** Toka ;
- **Grupi 2:** Mjetet e kategorisë së parë, (Ndërtesa dhe strukturat tjera ndërtimore me normën e zhvlerësimit prej 5%) ;
- **Grupi 3:** Mjetet e kategorisë së dytë, (me normën e zhvlerësimit prej 20%) dhe
- **Grupi 4:** Mjetet e kategorisë së tretë, (me normën e zhvlerësimit prej 15%) .

**Direktivë për tatimpaguesin-blerësin:**

Metoda e shpërndarjes të vlerës për secilin prej katër grupeve mundë të bëhet si në vijim: Duke u bazuar në gjendjen e fundit të bilancit të Ndërmarrjes Shoqërore do të bëhet llogaritja e përqindjes së pjesëmarrjes për secilin grup. Nëse bilanci nuk ekziston atëherë përqindja e shpërndarjes së vlerës do të bëhet nga Tatimpaguesi sipas këtyre rregullave :

- Përcaktimi i vlerës së tokës, derisa në praktikë nuk zbatohet tatim në pronë për tokë, do të definohet vlera duke u bazuar në tri krahasime të cilat i përgjigjen: kohës, madhësisë, vendit dhe rrethanave.
- Vlera e grupit 2 (ndërtesat dhe konstruktionet tjera) do të përcaktohet duke u bazuar në vlerësimin nga Kuvendet Komunale që janë bërë për qëllime të Tatimit në Pronë.
- Kurse vlera e mjeteve të kategorisë 2 dhe 3 do të shpërndahet në mënyrën më të arsyeshme nëpër këto dy kategori, duke pasur parasysh koston historike dhe jetën e vlefshmërisë. Në këtë detyrë të shpërndarjes së vlerës për këto dy grupe, nuk ka dallim të rëndësishëm ndërmjet shkallës së amortizimit prej 20% dhe 15% , prandaj sugjerohet të bëhet ndarja më e arsyeshme.

**Hapi 3: Shpërndarja e vlerës së mjeteve themelore për secilin grup sipas përqindjes së pjesëmarrjes të llogaritur në hapin 2 dhe në shumën e Ofertës**

Bazuar në hapin 2 , tatimpaguesi do të nxjerrë një vlerë të mjeteve themelore për të cilën pastaj do të nxirren përqindjet e pjesëmarrjes për secilën nga katër kategoritë. Bazuar në ato përqindje do të nxjerrë bazën për përlllogaritjen e zhvlerësimit për secilën nga katër kategoritë duke shumëzuar përqindjet me vlerën e mjeteve themelore të përlllogaritur sipas formulës dhe shumës së ofertës në hapin e parë.

Pasi të jetë nxjerrë baza për përlllogaritjen e zhvlerësimit për secilën kategori, zhvlerësimi do të përlllogaritet duke respektuar nenet 14 , 15 dhe 16 të Rregullores 2004/51 për Tatimin në të Ardhura të Korporatave e cila është ndryshuar me Rregulloren 2005/51 , si dhe duke respektuar nenet 9.4 dhe 9.5 të Rregullores 2004/52 mbi Tatimin në të Ardhura Personale.



Vërejtje: Nëse Tokës dhe Stoqeve nuk iu është dhënë vlerë e arsyeshme , atëherë ATK me anë të procesit të kontrollit do të ketë të drejtë të bëjë vlerësimin e këtyre dy kategorive duke respektuar rregullat e këtij Shpjegimi Publik .

**Shembull :**

Tatimpaguesi bazuar në procedurën që është dhënë në hapin e dytë ka rezultuar të ketë këtë vlerën e mjeteve themelore:

	<u>Vlera</u>	<u>Përqindja</u>
1. Toka	= 100,000 euro -----	= 14 %
2. Ndërtesa	= 200,000 euro -----	= 29 %
3. Mjetet e kategorisë 2	= 150,000 euro -----	= 21 %
4. <u>Mjetet e kategorisë 3</u>	= 250,000 euro -----	= 36 %
<u>Totali</u>	= 700,000 euro -----	=100%

Nga përlllogaritjet që janë bërë në hapin 1 (psh: *V.m.th.* = Shuma e ofertuar 1,150,000 + Obligimet 100,000 - Kërkesat 150,000 – Stoqet 100,000) ka rezultuar që vlera e mjeteve themelore të jetë =1,000,000 euro. Duke u bazuar në këtë shumë nxjerrim bazën për përlllogaritjen e zhvlerësimit :

	<u>Përqindja* vlera e m.th = Baza për përlllogaritjen e zhvlerësimit</u>
1. Toka	= 14 % * 1,000,000 = 140,000 <i>Vlera e tokës (e pa zhvlerësueshme)</i>
2. Ndërtesa	= 29 % * 1,000,000 = 290,000 <i>vlera e objektit (zhvlerësimi 5%)</i>
3. Mjetet e kategorisë 2	= 21 % * 1,000,000 = 210,000 <i>vlera e mjeteve (zhvlerësimi 20%)</i>
4. <u>Mjetet e kategorisë 3</u>	= 36% * 1,000,000 = 360,000 <i>vlera e mjeteve (zhvlerësimi 15%)</i>
<u>Totali</u>	= 100 % ----- 1,000,000

Ky shpjegim publik do të ju jep të drejtën të gjithë Tatimpaguesve (blerës) që të njohin zhvlerësimin e Aseteve të ndërmarrjeve të privatizuara në mënyrë retroaktive. Pra Tatimpaguesit të cilët deri më tani nuk e kanë njohtë zhvlerësimin , do të mund të bëjnë korrigjimin e Deklaratave Vjetore.

Vlerat e përcaktuara për Asete sipas këtij Shpjegimi Publik do tu japin të drejtën Tatimpaguesve (blerës) që të njohin zhvlerësimin vetëm për Asetet të cilat janë në përdorim apo deri në kohën kur kanë qenë në përdorim. Nëse asetit është shkatërruar me vullnetin e tatimpaguesit (blerësit), pasi që i është dhënë vlera sipas rregullave të këtij shpjegimi, në këto raste vlera e mbetur nuk do të zhvlerësohet dhe e njëjta nuk do të njihet si shpenzim. Në rastet e shkatërrimit pa vullnetin e tatimpaguesit ( blerësit ) apo në rastin e shitjes së aseteve, do të respektohen neni 7 dhe neni 19 i Rregullores 2004/51 mbi Tatimin në të Ardhura të Korporatave, apo neni 9.2 dhe neni 14 i Rregullores 2004/52 mbi Tatimin në të Ardhura Personale.

Metodat përlllogaritëse në këtë shpjegim publik do të përdoren për qëllimin e njohjes së zhvlerësimit për asetet e ndërmarrjeve të privatizuara nga AKM dhe nuk mund të përdoren për qëllime tjera.

Prishtinë 26.05.2008

Drejtori i ATK-së - Naim Fetahu


